



Lënda: Kërkesë për informacion dhe Akses në Dokumente Vlerësimi, Evidentimi dhe Plan Masash pas Tërmetit 21 shtator 2019.
Për: Znj. Olta Xhacka Ministria e Mbrojtjes
Z. Haki Cako, drejtor Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (ish Drejtoria e përgjithshme e Emergjencave Civile).
Nga: AIS / Open Data Albania
Data: 04.12.2019

I/E nderuar titullar i Institucionit,

AIS është një Organizatë jo fitimprurëse e njohur si promotore e informacionit transparent përmes Open Data Albania, duke shprehur konsideratë për Punën e Institucionit tuaj po parashtrijmë kërkesë për informim dhe akses në dokumenta si vijon:

1. Kopje për çdo dokument të tipit, memo, relacion, procesverbal, udhëzim, akt, shkresë, njoftim të mbajtur nga Institucioni juaj apo i hartuar nga Pushteti Vendor (prefektura, qarku bashkia) dhe i depozituar pranë Emergjencave Civile me Objekt Evidentim, Vlerësim, Raportim, Plan Masash për gjendjen e krijuar në banesa private, godina biznesi dhe shtetërore pas Tërmetit të datës 21 Shtator 2019.
2. Dokument, masa të mara pas këtij tërmetit (data 21 shtator) për evakuim dhe mos përdorim të godinave të klasifikuar me risk sipas kategorive.

Kjo kërkesë bazohet në Legjislacionin tonë për të Drejtën e Informimit dhe në parime të transparencës për mirëqeverisje.

Në pritje të përgjigjes tuaj dhe kopjeve të dokumenteve të kërkuara.

Me respekt

Aranita BRAHAJ
Drejtoreshë Ekzekutive
Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS)

Adresë postare:
Rr "Asim Vokshi"
Pallati 13/25 Kati 3
Tiranë.
Tel 0682001718
Email: aranita.brahaj@ais.al

